

URDHËR
Nr. 715, datë 3.4.2013

PËR PËRCAKTIMIN E SHKELJEVE TË TJERA TË LIGJIT NR. 9049, DATË 10.4.2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të pikës 1 germa “d” të nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, me ligjin nr. 85/2012, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

URDHËRON:

Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në nenin 1 germa “d” të nenit 40 të këtij ligji, në rastet kur:

1. Deklarimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre, detyrimeve financiare nga subjekti apo personi i lidhur me të, nuk bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

2. Subjekti deklarues, apo personi i lidhur me të, nuk merr masa për të rregulluar brenda afatit ligjor pasaktësitë e konstatuara gjatë përpunimit paraprak të deklaratës së interesave private, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar.

3. Subjekti deklarues, apo personi i lidhur me të, nuk paraqitet brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, për të dhënë shpjegime mbi deklarimin e interesave private.

4. Subjekti deklarues, apo personi i lidhur me të, nuk depoziton dokumentet justifikuese, për pasuritë, detyrimet financiare dhe burimet e krijimit të tyre, të pasqyruara në deklaratën e interesave private.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME
Zana Xhuka